

**Auditues Ligjor**  
**Anita Pulaj**

## **RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR**

**Për Auditimin e fondeve të përfituara dhe të  
shpenzuara nga subjekti  
“Partia Demokratike e Shqipërisë”  
për vitin kalendarik 2016**

**Tiranë më 12/10/2017**

**16**

## RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

### Drejtuar: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Partisë Demokratike të Shqipërisë Tiranë

#### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të subjektit "Partia Demokratike e Shqipërisë" të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, për pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2016 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, **në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të OJF-ve.**

#### **Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### **Çështjet Kryesore të Auditimit**

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

#### **Përgjegjësitë e Administratorëve dhe të Personave të Ngarkuar me Mbikqyrjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për të tillakontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.



Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekzistonbashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.



*Auditues Ligjor (Ekspert kontabël i regjistruar)*

*Anita Pulaj*

*Licensë Nr 155, datë 08.06.2006*

---

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit

**Auditues ligjor (Ekspert Kontabël i Regjistruar )**

**Tiranë më 12/10/2017**

**ANITA PULAJ**



BLV. Gjergj Fishta, Pall G&P, hyrja II, kati II, mbi Credins Bank, Tiranë  
Nr. Kontakti Cel.0692087743 , e-mail pulaj\_anita@yahoo.com

**Emërtimi dhe Forma ligjore:**  
**NIPT –i:**  
**Adresa e Selisë:**  
**Data e regjistrimit:**  
**Veprimtaria Kryesore:**

**Partia Demokratike e Shqipërisë**  
**K51919009E**  
**Tiranë**  
**12 dhjetor 1990**  
**Parti Politike**

## **PASQYRAT FINANCIARE**

(Në zbatim të Standartit Kombëtar Të Organizatave Jo Fitimprurese)

**VITI 2016**

Pasqyrat Financiare janë individuale  
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në Lek  
Pasqyrat Financiare nuk janë të rrumbullakosura  
Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2016-31.12.2016  
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare

**"PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE"**  
**NUIS K51919009E**

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**31 dhjetor 2016**

I	AKTIVET	Shenimi	2016	2015
<b>I</b>	<b>Aktivitet afatshkurtra</b>			
a	Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	1	29,555,160	24,636,261
b	Inventarë dhe shpenzime të parapaguara	2	120,000	120,000
	<b>Shuma I</b>		<b>29,675,160</b>	<b>24,756,261</b>
<b>II</b>	<b>Investime financiare afat gjata</b>			
1	Aktive të kufizuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje			
a	Ndertesa		25,080,547	26,400,589
b	Makineri dhe pajisje		21,506	26,882
c	Pajisje informatike dhe mobilje zyre		10,384,412	12,980,515
d	Mjete transporti		8,030,857	10,038,571
e	Pajisje informatike 2016		2,010,053	
	<b>Shuma II</b>	<b>3</b>	<b>45,527,375</b>	<b>49,446,557</b>
	<b>Totali i aktiveve I+II</b>		<b>75,202,534</b>	<b>74,202,818</b>
<b>III</b>	<b>DETYRIMET</b>			
1	Të pagueshme		3,395,299	3,003,575
2	Detyrime tatimore		739,402	914,765
3	Kontribute të marra në avancë			
4	Grante			
5	Premtime të kushtëzuara për të dhënë(karte krediti)		470,722	
6	Hua afat gjatë			
	<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>4</b>	<b>4,605,423</b>	<b>3,918,340</b>
<b>IV</b>	<b>AKTIVET NETO</b>			
<b>1</b>	<b>Të kufizuara</b>		-	-
a	Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten			
b	Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash			
<b>2</b>	<b>Të pakufizuara (I+II-III)</b>	<b>5</b>	<b>70,597,111</b>	<b>70,284,478</b>
	<b>Totali i aktiveve neto</b>		<b>70,597,111</b>	<b>70,284,478</b>

**"PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE"**  
**NUIS K51919009E**

**Pasqyra e Aktiviteteve (performancës)**

**31 dhjetor 2016**

	Përshkrimi i zërit	shenimi	2016	2015
	Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:			
I	<b>Të ardhurat:</b>			
1	Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit			
2	Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare		-	
3	Të ardhura nga Buxheti I shtetit		57,179,867	71,340,573
4	Të ardhura nga investimet apo dhurimet asetesh			
5	Tarifat për shërbimet			
6	Të ardhura nga aktivitetet tregtare			
7	Të ardhura të tjera			110,000
	<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara</b>	<b>6</b>	<b>57,179,867</b>	<b>71,450,573</b>
II	<b>Aktive neto të çliruara nga kufizimet:</b>			
1	Realizimi i kufizimeve të programit			
2	Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve			
3	Përfundimi i kufizimit të afatit			
	<b>Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet</b>			
	<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:</b>			
IV	<b>Shpenzime për aktivitetet</b>			
1	Aktiviteti A	7	(54,891,882)	(133,144,837)
2	Shpenzime për amortizimin e asetëve	8	(6,244,705)	(7,852,083)
3	Të ardhura dhe shpenzime financiare	9	81,215	(96,617)
	<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(61,055,372)</b>	<b>(141,093,537)</b>
V	<b>Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)</b>		<b>(3,875,505)</b>	<b>(69,642,964)</b>
1	Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:			
2	Sistemim për vlerat monetare si dhe detyrimet nga viti 2015	10	4,188,137	-
3	Të ardhurat nga investimet afatgjatë			
4	afatgjatë			
5	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor			
6	Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)			
	<b>Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)</b>		<b>4,188,137</b>	
	<b>Ndryshimi në aktivet neto (A + B)</b>	<b>11</b>	<b>312,633</b>	<b>(69,642,964)</b>
	<b>Aktive neto në fillim të vitit</b>		<b>70,284,478</b>	<b>139,927,442</b>
	<b>Aktive neto në fund të vitit</b>		<b>70,597,111</b>	<b>70,284,478</b>

**"PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE"**  
**NUIS K51919009E**

**Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare**  
**31 dhjetor 2016 Metoda Indirekte**

<b>AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT</b>	shenimi	2016	2015
Ndryshimet në aktivet neto		312,633	(69,642,964)
Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto			
Amortizimi dhe zhvlerësimi		6,244,705	7,852,083
Humbjet e realizuara dhe të porealizuara në investime			
Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makineri pajisjeve			
Kontributet jo në para			(110,000)
Rritjet / Rënit jo në para të inventarëve			
Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma			
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:			
Të tjera të arkëtueshme			
Shpenzime të parapaguara			
Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme			(1,307,316)
Të pagueshme		687,083	206,617
Bamirësi mbi baza vjetore			
<b>Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		<b>7,244,421</b>	<b>(63,001,580)</b>
<b>AKTIVITETET INVESTUESE</b>			
Blerje / Shitje investimesh			
Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata		(2,325,522)	(1,233,900)
Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme			
Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme			
<b>Flukse neto nga aktivitetet investuese</b>		<b>(2,325,522)</b>	<b>(1,233,900)</b>
<b>AKTIVITETET FINANCUESE</b>			
Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime /			
Principal i paguar për dëftesat e pagueshme			
<b>Flukse neto nga aktivitetet financuese</b>			
<b>Rritje / Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre</b>		<b>4,918,899</b>	<b>(64,235,480)</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës</b>		<b>24,636,261</b>	<b>88,871,741</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës</b>		<b>29,555,160</b>	<b>24,636,261</b>
<b>Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për tatim taksë</b>		<b>8,777,149</b>	<b>1,970,991</b>



**SHENIMET SHPJEGUESE****I. Informacion i përgjithshëm për Partinë “Partia Demokratike e Shqipërisë”**

(PD) Partia Demokratike e Shqipërisë është krijuar në 12 dhjetor 1990. Në organet tatimore është regjistruar me NIPT K51919009E.

Partia Demokratike e Shqipërisë është parti politike që bashkon në gjirin e saj shtetasit shqiptarë që besojnë, respektojnë e mbrojnë lirinë, dinjitetin e personit, vlerat themelore të familjes në shoqëri, drejtësinë dhe shtetin ligjor, humanizmin e solidaritetin shoqëror.

Partia Demokratike e Shqipërisë aderon në gjirin e Partisë Popullore Europiane dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga të njëjtat vlera e ideologji.

Partia Demokratike shqiptare synon:

Të ndërtojë një demokraci të drejtave njerëzore të njohura e të marra në mbrojtje nga dokumentat ndërkombëtare, të mbështetur në bashkësinë e njerëzve të lirë.

Të ndërtojë shtetin ligjor me raporte të balancuara e të ndara qartë të pushteteve, garant të jetës, lirive dhe të drejtave të sanksionuara me ligj të Qytetarëve etj.

Partia Demokratike e Shqipërisë e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, kryesisht:

- Ligji nr. 8580, datë 17/02/2000 “Për Partitë Politike” i ndryshuar me ligjin nr. 10374 datë 10/02/2011 dhe me ligjin nr. 90/2017 datë 22/05/2017
- Ligji nr. 10019, datë 29/12/2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)
- Akte nënligjore.

Partia Demokratike e Shqipërisë e ka selinë në kryeqytetin e Shqipërisë në Tiranë.

Organizimi i Përgjithshëm i Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Instancat dhe organet qendrore të PD-së janë

- a) Kuvendi i partisë
- b) Këshilli Kombëtar
- c) Kryetari dhe Zëvendësi i tij
- d) Kryesia e PD-së
- e) Sekretari i Përgjithshëm
- f) Departamentet
- g) Sekretarët funksional
- h) Komiteti i orientimit të politikave

Kryesia e partisë përbëhet nga:

- a) Kryetari i partisë
- b) Nenkryetarët e partisë
- c) Sekretari i përgjithshëm, drejtuesit e departamenteve dhe sekretarët funksionalë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.
- d) Kryesia e grupit parlamentar, ku përfshihen, Kryetari, nënkryetari, sekretari dhe zëdhënësi

- e) Kryetari apo Nënkryetari që i përket grupit Parlamentar të PD-së
- f) Kryetarët apo nënkryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare.
- g) Kryetarët e organizatave partnere.

Kryetar i Partisë është Z. Lulzim BASHA

#### Organizatave Partnere

- Forumi Rinor i Partisë Demokratike të Shqipërisë.
- Lidhja Demokratike e Gruas.

#### Financat e Partisë

Burimet financiare të partisë përbëhen nga kuotat e antarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma dhe dhurata sipas ligjit për partitë politike, etj.

Për vitin 2016 burimet financiare të partisë janë vetëm nga granti i dhënë nga buxheti i shtetit.

## **II. Baza për përgatitjen e pasqyrave financiare të periudhës**

Nga data 1 janar 2016 është efektiv Standarti Kombëtar i Kontabilitetit për OJF-te për pasqyrat financiare të hartuara për periudha raportuese që fillojnë pas datës 01 Janar 2016.

SKK për OJF-të synohet të zbatohet nga të gjitha ato organizata që kanë statusin e njësive ekonomike jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri. Janë objekt i këtij standarti fondacionet, shoqatat, qendrat, **partitë politike**, institucionet fetare, sindikatat dhe çdo organizatë tjetër e papërmendur në këtë paragraf, por që ka statusin e një organizate jofitimprurëse, përveç atyre OJF-ve apo disa prej veprimtarive të tyre, të cilat me ligj të veçantë, përjashtohen nga detyrimi për të ndërtuar dhe raportuar pasqyrat e tyre financiare.

Kërkesat e këtij Standarti do të zbatohen në të gjitha pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me këtë Standart nga ato organizata që kanë një identitet ligjor të veçantë, të cilat:

- 1- Janë krijuar për të kryer aktivitete të veçanta të një natyre altruiste;
- 2- Nuk taten (për aq sa nuk kryejnë aktivitet ekonomik fitimprurës);
- 3- Janë të ndaluar t'i shpërndajnë tepricat nga aktivitetet tek themeluesit dhe/ose antarët; dhe
- 4- Nuk zotërohen ose kontrollohen nga Qeveria.

Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas këtij Standarti është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të Partisë politike Jo Fitimprurëse, të dobishëm për qëllime të përgjegjësisë dhe vendimarrjes së përdoruesve të këtyre pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të Subjektit politik, vetëm dhe vetëm nëse:

- a. Ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- b. Përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arsyeshme e të bazuara (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme); dhe
- c. Shënimet në pasqyrat financiare janë të përgatitura në detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të

Subjektit politik, në mënyrë të tillë që lexuesit kompetentë të mund të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.

Paraqitja e vërtetë dhe e besueshme nënkupton që:

Parimet-bazë dhe kërkesat e tjera, të paraqitura nga neni 9 deri 12 të Ligjit të Kontabilitetit Nr. 9228, si dhe paragrafët 40-90 të SKK 1 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, janë përdorur si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare të Subjektit politik;

Aktivet, detyrimet, aktivet neto, të ardhurat dhe shpenzimet, të paraqitura në pasqyrat financiare të Subjektit politik, përmbushin kriteret e përkufizimeve të dhëna në këtë standart.

### **Performanca**

Performanca tregohet nga marrëdhënia e të ardhurave dhe shpenzimeve të një Subjektit politik gjatë një periudhe raportuese.

Të ardhurat dhe shpenzimet përcaktohen si vijon:

Të ardhurat janë rritje të përfitimeve ekonomike ose formave të tjera të mundshme të përfitimeve, gjatë periudhës raportuese, të cilat rezultojnë si shtim i aktiveve ose si pakësim i detyrimeve;

Shpenzimet janë zvogëlimet në përfitimet ekonomike ose formave të tjera të mundshme të përfitimeve, gjatë periudhës raportuese, të cilat rezultojnë si pakësim i aktiveve ose si shtim i detyrimeve.

### **Aktivi**

Aktivi është një objekt ose e drejtë ekonomike e kontrolluar nga subjekt politik, i cili:

Ka ardhur si rezultat i ngjarjeve të shkuara; dhe

Nga përdorimi, i të cilit priten në të ardhmen përfitime ekonomike ose forma të tjera të mundshme të përfitimeve.

### **Detyrimet**

Detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar të Subjektit politik janë detyrime aktuale të cilat:

Kanë lindur nga ngjarje të shkuara; dhe

Shlyerja e tyre pritet të shoqërohet në të ardhmen me daljen e përfitimeve ekonomike apo të llojeve të tjera të përfitimeve të mundshme.

### **Aktivet neto**

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të Subjektit politik në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Aktivet neto, mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori, ndahen në:

**Aktive neto të kufizuara, dhe**

**Aktive neto të pakufizuara.**

### **Paraqitja e Pasqyrave Financiare të Subjektit politik**

Ky seksion përcakton parimet për hartimin e pasqyrave financiare të organizatave jofitimprurëse.

Pasqyrat financiare të Subjektit politik përbëhen nga:

- pasqyra e pozicionit financiar
- pasqyra e aktiviteteve, dhe
- pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

Organizatave jo fitimprurëse japin në shënimet shpjeguese informacione të tjera shtesë të nevojshme për të kuptuar llojin e aktiviteteve dhe shërbimeve që kryejnë.

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

### Qëllimi dhe objekti i pasqyrës së pozicionit financiar

Qëllimi kryesor i pasqyrës së pozicionit financiar është të japë informacionin e duhur mbi aktivet, detyrimet dhe aktivet neto të Subjektit politik si dhe marrëdhëniet e tyre me njëra tjetrën në një moment të caktuar kohe. Informacioni i dhënë në pasqyrën e pozicionit financiar i përdorur së bashku me informacionin e dhënë në shënimet shpjeguese apo informacionin e pasqyrave të tjera financiare, ndihmon donatorët, anëtarët, kreditorët dhe të tjerë përdorues të vlerësojnë,

- (a) Aftësinë e Subjektit politik për të vazhduar ofrimin e shërbimeve dhe
- (b) Likuiditetin e Subjektit politik, fleksibilitetin financiar, aftësinë për të shlyer detyrimet dhe nevojat për financime të jashtme.

### Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve

Pasqyra e pozicionit financiar, përfshirë shënimet shpjeguese për pasqyrat, jep informacionin e duhur rreth likuiditetit, fleksibilitetit financiar dhe marrëdhënies mes aktiveve dhe detyrimeve të Subjektit politik. ky informacion jepet në pasqyrë duke i bashkuar aktivet (detyrimet) me karakteristika të njëjta në grupime të arsyeshme homogjene.

### Klasifikimi i aktiveve neto si të kufizuara dhe të pakufizuara nga donatorët

Pasqyra e pozicionit financiar e përgatitur nga një subjekt politik paraqet shumat e secilës prej dy klasave të aktiveve neto:

#### Aktive neto të kufizuara dhe Aktive neto të pakufizuara;

mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori.

#### Aktivet neto të kufizuara

Brenda kategorisë së aktiveve neto të kufizuara, duhet të paraqiten në zëra të veçantë, në pasqyra apo në shënime shpjeguese, si më poshtë:

Aktivet si p.sh, toka apo veprat e artit të dhuruara, me përcaktimin që të përdoren për qëllime specifike, të ruhen dhe të mos shiten, ose

Aktive të dhuruara me qëllim që të investohen për të siguruar një burim të përhershëm të ardhurash;

### Qëllimi dhe objekti i Pasqyrës së Aktiviteteve

Qëllimi kryesor i pasqyrës së aktiviteteve i përdorur së bashku me shënimet shpjeguese është të japë informacionin e nevojshëm mbi

- (a) efektet rreth transaksioneve të ngjarjeve apo rrethanave të tjera që çojnë në ndryshimin e shumave dhe natyrës së aktiveve neto,
- (b) marrëdhëniet e këtyre transaksioneve, ngjarjeve e rrethanave të tjera me njëra tjetrën dhe
- (c) si përdoren burimet e Partisë politike për të ofruar programe apo shërbime të ndryshme.

Informacioni i paraqitur në pasqyrën e aktiviteteve i përdorur së bashku me shënimet shpjeguese apo informacionin e pasqyrave të tjera, ndihmon donatorët, kreditorët e të tjerë përdorues që të;

- (1) vlerësojnë performancën e Partisë politike gjatë periudhës,
- (2) vlerësojnë përpjekjet e Partisë politike për të ofruar shërbime dhe aftësinë e saj për të vazhduar në ofrimin e shërbimeve,
- (3) vlerësojnë se si drejtuesit e Partisë politike delegojnë përgjegjësitë dhe bashkëpunojnë me të tjerët
- (4) aspekte të tjera të performancës së organizatës.

### **Kontributet e marra**

Kontributet e marra duhet të njihen si të ardhurave ose fitime në periudhën kur merren si aktive, pakësim të detyrimeve apo shpenzimeve në varësi të formës së përfitimit të marrë. Kontributet e marra maten me vlerën e tyre të drejtë.

### **Kontributet në formën e shërbimeve**

Kontribute në shërbime do të njihen nëse shërbimet e përfituara

(a) krijojnë ose shtojnë aktive jofinanciare ose

(b) kërkojnë aftësi të specializuara të ofruara nga individë që i kanë këto aftësi dhe nëse nuk përfitoheshin si donacion do duhej të bliheshin. Shërbimet që kërkojnë aftësi të specializuara ofrohen nga arkitektë, kontabilistë, hekurkthyesit, doktorët, elektrikistët, avokatët, infermierët, hidraulikët, mësuesit, zejtarët dhe profesionistë të tjerë.

Kontributet në shërbime dhe premtimet për të dhënë shërbime që nuk plotësojnë kriteret e mësipërme nuk do të njihen në pasqyrat financiare.

## **III. Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare.**

### **Bilanci kontabël, aktivet**

#### **1. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Aktivt dhe detyrimet në monedha të huaja dhe që janë paraqitur me vlerë të drejtë përkthehen në lekë me kursin e këmbimit në datën që është përcaktuar vlera e drejtë.

Monedhat e huaja me të cilat operon Partia janë Euro, USD dhe CHF. Kursi i këmbimit zyrtar i Bankës së Shqipërisë (Leku kundrejt njësisë së monedhave të huaja) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Euro (Euro)	135.23	137.28
Dollarë (USD)	128.17	125.79
Franga Zviceriane (CHF)	126.05	126.74

Gjëndja e mjeteve monetare në datë 31.12.2016 paraqitet në shumën 29,555,159.61 lekë si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Likujditete</b>	<b>Viti 2016</b>	<b>Viti 2015</b>
1	Depozita nëbankë	29,136,411	24,216,261
2	Para në arkë	418,749	420,000
	<b>Totali</b>	<b><u>29,555,160</u></b>	<b><u>24,636,261</u></b>

Gjëndja e detajuar e bankave më 31.12.2016 është në tabelën e mëposhtme:

Nr	Llogaria bankare	Lekë	Euro	USD	CHF	Totali konvertuar në lekë
1	Internacional Comercial Bank në lekë	4,085,859.81	-	-	-	4,085,859.81
2	Internacional Comercial Bank në euro	-	-	-	-	-
3	Internacional Comercial Bank në usd	-	-	1,078.24	-	138,198.02
4	Raiffeisen Bank 0101003045, në lekë	18,836,633.20	-	-	-	18,836,633.20
5	Raiffeisen Bank 8020003045 ne euro	-	(1.00)	-	-	(135.23)
6	Raiffeisen Bank 6000003045 ne euro	-	5,000.00	-	-	676,150.00
7	Raiffeisen Bank 8030003045 ne USD	-	-	36.93	-	4,733.32
8	Raiffeisen Bank 8010003045 ne CHF	-	-	-	1,069.43	134,801.65
9	Credins Bank 647336 në lekë	(3,090.17)	-	-	-	(3,090.17)
10	Credins Bank 168634 në lekë	165,772.78	-	-	-	165,772.78
11	Credins Bank 169085 në USD	-	-	39,771.30	-	5,097,487.52
<b>Shuma</b>		<b><u>23,085,175.62</u></b>	<b><u>4,999.00</u></b>	<b><u>40,886.47</u></b>	<b><u>1,069.43</u></b>	<b><u>29,136,410.81</u></b>

## 2. Inventarë dhe shpenzime të parapaguara

Paraqitet shuma prej 120,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e materialeve ndihmëse të partisë, më 31.12.2016, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2015
1	Inventarë dhe shpenzime të parapaguara	120,000	120,000
<b>Totali</b>		<b><u>120,000</u></b>	<b><u>120,000</u></b>

## 3. Investime financiare afat gjata

Gjendja e aktiveve është paraqitur me vlerën kontabël të mbetur, në shumën 45,527,375 lekë si më poshtë:

Nr	Investime financiare afat gjata	Viti 2016	Viti 2015
1	Ndërtesa	25,080,547	26,400,589
2	Makineri dhe pajisje	21,506	26,882
3	Pajisje informatike dhe mobilje zyre	10,384,412	12,980,515
4	Mjete transporti	8,030,857	10,038,571
5	Pajisje informatike 2016	2,010,053	-
<b>Totali</b>		<b><u>45,527,375</u></b>	<b><u>49,446,557</u></b>

Si politikë kontabël për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, partia ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e hyrjes është bërë me kosto dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga rënia e vlerës. Drejtimi nuk ka llogaritur rënie të vlerës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016.

**Totali i aktivitet për vitin 2016 paraqitet në shumën 75,202,534 lekë.**

**Bilanci kontabël, pasivet**

**4. Detyrimet**

Në këtë post paraqitet gjëndja e detyrimeve më 31.12.2016 në shumën 4,605,423 lekë, e detajuar si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2015
1	Të pagueshme ndaj furnitorëve	3,395,299	3,003,575
2	Detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore, tap	739,402	914,765
3	Detyrimi për kartë krediti	470,722	-
	<b>Totali I detyrimeve</b>	<b><u>4,605,423</u></b>	<b><u>3,918,340</u></b>

4.1 Detyrimi ndaj furnitorëve në shumën 3,395,299 lekë, është i detajuar më poshtë:

Nr	Të pagueshme ndaj furnitorëve	Viti 2016
1	Mektrin Motors	2,930,462
2	OSHEE	402,197
3	Dritan Nelaj	62,640
	<b>Totali</b>	<b><u>3,395,299</u></b>

**5. Aktive Neto të pakufizuara**

Në këtë post paraqitet diferenca midis aktivitetit dhe totalit të detyrimeve më 31.12.2016 në shumën 70,597,111 lekë, e cila përfaqëson gjëndjen pasurore të partisë.

Nr	Aktive Neto te pakufizuara	Viti 2016	Viti 2015
1	Te pakufizuara	70,597,111	70,284,478
	<b>Shuma</b>	<b><u>70,597,111</u></b>	<b><u>70,284,478</u></b>

**Pasqyra e Të Ardhurave Dhe Shpenzimeve****6. Të ardhurat**

Të ardhurat e përfituara nga partia, nga Buxheti i Shtetit, për përmbushjen e objektivit të saj për vitin 2016 janë në shumën 57,179,867 lekë, si më poshtë:

Nr	Të ardhurat	Viti 2016	Viti 2015
1	Të ardhura nga Buxheti i Shtetit	57,179,867	71,340,573
	<b>Shuma</b>	<b><u>57,179,867</u></b>	<b><u>71,340,573</u></b>

**7. Shpenzime për aktivitetet**

Në këtë zë janë të përfshira shpenzimet të cilat i shërbejnë arritjes së objektivave të partisë, për vitin 2016 në shumën 61,055,372 lekë, të përmbledhura si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2015
1	Aktiviteti A	(54,891,882)	(133,144,837)
2	Shpenzime për amortizimin e asetëve	(6,244,705)	(7,852,083)
3	Te ardhura dhe shpenzime financiare	81,215	(96,617)
	<b>Shuma</b>	<b><u>(61,055,372)</u></b>	<b><u>(141,093,537)</u></b>

**7.1 Aktiviteti A**

Të detajuara shpenzimet në shumën 54,891,882 lekë janë si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Shuma
----	----------	-------

1	Bl. energji, avull ,uje	3,802,699
2	Karburant	1,862,000
3	Qera zyre	3,781,660
4	Qera salle tek Muzeu Historik Tirane	15,000
5	Qera salle tek rektorati, Universiteti i Tiranës	15,000
6	Qera per makinën Mercedes Benz	1,440,000
7	Qera amfiteatri per aktivitetin 04.06.2016	105,000
8	Sherbim mirembajtje	515,694
9	Sherbim sistemi HVAC me fature Gener 2	57,023
10	Rregjistrim Domain	70,000
11	Shpenzime mirembajtje per makinën me qera	226,650
12	Te tjera	89,126
13	Konsum uje i pijshem	208,500
14	Kancelari	337,375
15	Banket ne The Plaza Tirana	48,600
16	Shpenzime per F/V mermer, astar, lyerje ,me	62,640
17	Sherbime noteriale	7,600
18	Sherbim auditimi	885,600
19	Transferime, udhetim, dieta	229,054
20	Donacione për Gazeta RD	2,800,000
21	Donacione për Rezidenca Studentore	50,000
22	Kontribut për partinë aleate PKD	460,000
23	Kontribut për partinë aleate LZHK	963,870
24	Shpz.postare e telekom.	2,279,265
25	Sherbim interneti	360,000
26	Sherbime bankare	27,623
27	Taksa dhe tarifa vendore	11,717
28	Taksa e regjistrimit	1,283,904
29	Pagat dhe shperblimet e personelit	26,220,453
30	Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	4,086,400
31	Shpenzime te tjera	89,253
32	Shpenzime me MC	720,242
33	Donacion per bustin e Azem Hajdarit	1,400,000
34	Shpenzime per interesa	379,934
	<b>Totali</b>	<b>54,891,882</b>

### 7.2 Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Paraqitet shpenzime për amortizimin e asetëve për vitin 2016 në shumën 6,244,705 lekë.

Nr Emërtimi	Viti 2016	Viti 2015
1 Shpenzime për amortizimin e asetëve	(6,244,705)	(7,852,083)
<b>Shuma</b>	<b>(6,244,705)</b>	<b>(7,852,083)</b>

### 7.3 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Paraqiten të ardhura të tjera për vitin 2016 në shumën 81,215 lekë, të detajuara si më poshtë:



Nr Emërtimi	Shuma
1 Interesa bankare	5,277
2 Fitim nga këmbimet valutore	75,939
<b>Totali</b>	<b><u>81,215</u></b>

**Totali i shpenzimeve për vitin 2016 paraqitet në shumën 61,055,372 lekë.**

### 8. Rritja/rënia e aktiveve neto te pakufizuara

Partia për nga vetë natyra dhe objekti i saj, nuk është fitimprurëse, por i shpenzon fondet e përfituara për të realizuar objektivat e përcaktuara. Në këtë post paraqitet rritja/rënia e aktiveve neto të pakufizuara, si më poshtë:

Nr	Rritja/rënia ne aktivet neto te pakufizuara	Viti 2016	Viti 2015
1	Te ardhura	57,179,867	71,450,573
2	Shpenzime	(61,055,372)	(141,093,537)
	<b>Rritja/rënia e aktiveve</b>	<b><u>(3,875,505)</u></b>	<b><u>(69,642,964)</u></b>

### 9. Sistemim

Në këtë pos paraqitet sistemim për vlerat monetare si dhe detyrimet nga viti 2015, në shumën 4,188,137 lekë.

### III –Shënime të tjera

Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat nuk bëhen rregullime nuk ka.

Gabime materiale të ndodhura në periudhat kontabël të mëparshme të konstatuara gjatë periudhës raportuese nuk ka.

### Hartuesi i pasqyrave

**Ilir Deryishi**  
Drejtori Financave

